

VENDIM
Nr.4, datë 2.2.2009

PËR LICENCIMIN E SUBJEKTIT
SHA UJËSJELLËS, PEQIN

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.400, datë 19.8.1999 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Të japë licencë për subjektin sh.a. Ujësjellës, Peqin për një periudhë 4-vjeçare, në kategoritë:

- A/1 Prodhim dhe grumbullim uji për konsum publik.
- A/2 Trajtimi i ujit për konsum publik në impiantet e pastrimit.
- B Shpërndarja e ujit për konsum publik.
- C/1 Largimi i ujërave të ndotura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi